

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës  
Ap.-Kz. Nr. 251/2011  
Prishtinë  
13 dhjetor 2011

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën sipas nenit 26 paragrafit (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK-së) më 13 dhjetor 2011, në ndërtesën e Gjykatës Supreme në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegit, Gjyqtares së EULEX-it Anne Kerber dhe Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës Emine Mustafa, Nesrin Llushta dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegit.

Me Zyrtarin ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, si procesmbajtës.

Në prani të

Prokurores Publike Ndërkombëtare Gabriele Walentich, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHk).

Në lëndën penale me numër AP-KZ 251/2011 kundër të pandehurit:

N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] i lindur më [REDAKTUE] në fshatin [REDAKTUE]  
[REDAKTUE] i biri i [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] Shqiptar i Kosovës,  
vendbanimi në [REDAKTUE] Kosovë, i martuar,  
baba i një (1) fëmije, shkollimi vetëm gjashë (6) klasë të shkollës fillore, automekanik,  
me gjendje ekonomike mesatare, me një dënim të mëhershëm, në paraburgim prej 21  
prillit 2009 deri më 23 shkurt 2010.

Sipas aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë në lëndën nr. P. Nr. 41/10 të datës 31 janar 2011, të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në të njëjtën ditë, i pandehuri është shpallur fajtor:

Sepse më 21 prill 2009, rrëth orës 21:05, në Stanoc të Poshtëm në Komunën e Vushtrrisë, N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] është munduar ta detyrojë P. [REDAKTUE] që të ketë marrëdhënie seksuale duke e përdorur një instrument të rrezikshëm. N. [REDAKTUE] f. D. [REDAKTUE] është paraqitur i maskuar prapa F. [REDAKTUE] ia ka mbyllur gojën dhe e ka tërhequr atë në një vend të përshtatshëm për ta kryer aktin seksual. Ai ka nxjerrë një thikë dhe i ka thënë: "qepe! qepe! Se mundem me të ther". P. [REDAKTUE] ka bërtitur me zë të lartë dhe f. D. [REDAKTUE] ka mbrojtur veten. N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ia ka prerë dorën e majtë me thikë dhe i ka shkaktuar disa gërvishje në fytyrë. N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE]

Duke vepruar kështu, i akuzuari N. [REDACTED] D. [REDACTED] ka kryer veprën penale Dhunim në tentativë në kundërshtim të nenit 193 paragrafit 3 pikës 3 në lidhje me nenin 20 të KPK-së:

Dhe është dënuar me:

Burgim në kohëzgjatje prej shtatë (7) viteve për veprën penale Dhunim në tentativë.

Koha e kaluar në paraburgim nga 21 prilli 2009 deri më 23 shkurt 2010 është llogaritur sipas nenit 73 paragrafit 1 të KPK-së.

Për më tepër, i akuzuari N. [REDACTED] D. [REDACTED] është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 102 paragrafit 1 të KPPK-së me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit dhe interpretimit.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit brenda afatit kohor ka paraqitur ankesë të datës 23 maj 2010 kundër aktgjykimit. Është pohuar se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal dhe se vendimi i shqiptuar kundër të akuzuarit mbi sanksionin penal do të kundërshtohet. Është propozuar anulimi i aktgjykimit të kundërshtuar duke e liruar të akuzuarin N. [REDACTED] D. [REDACTED] nga aktakuza sipas nenit 390 paragrafit 3 të KPPK-së, ose në rastin më të keq, të shpallet fajtor për shkaktim të lëndimeve të lehta trupore sipas nenit 153 paragrafit 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së).

ZPShK-ja, me përgjigjen e datës 31 tetor 2011 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme të Kosovës më 04 nëntor 2011, ka kundërshtuar ankesën dhe ka propozuar që ajo të refuzohet si e pabazuar, duke e vërtetuar aktgjykimin e kundërshtuar.

Në bazë të aktgjykimit me shkrim në lëndën P, Nr. 41/10 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 31 janar 2011 (i paraqitur në shkrimoren e asaj Gjykate në të njëjtën ditë), ankesës së të pandehurit të dorëzuar me shkrim, shkresave përkatëse të dosjes dhe parashtresave verbale të palëve gjatë shqyrtimit më 13 dhjetor 2011, së bashku me analizën e ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës pas këshillimit të mbajtur më 13 dhjetor 2011, lëshon këtë:

#### AKTVENDIM

Ankesa e avokatit mbrojtës në emër të pandehurit N. [REDACTED] D. [REDACTED] kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, P. Nr. 41/2010, të datës 31 janar 2011, pranohet.

Aktgjykimi i ankimuar anulohet në bazë të ankesës dhe sipas detyrës zyrtare kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim dhe vendosje.

## **ARSYETIM**

### **Historia e procedurës**

Më 21 prill 2009, rrëth orës 21.05, në fshatin Stanoc i Poshtëm në Komunën e Vushtrrisë, F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ka zbritur nga autobusi dhe ishte duke u kthyer nga puna në shtëpi. Ishte errët dhe derisa ishte duke ecur në drejtim të shtëpisë së saj ajo u sulmua nga prapa nga një mashkull i cili mbante maskë dhe ishte veshur me rroba të zeza, ai menjëherë ia ka mbyllur gojën me njëren dorë që ta parandaloj që të bërtas. Ai e ka ulur në gjunjë dhe ajo ka parë se ai kishte një thikë në dorën tjetër. Ai vazhdonte t'i thoshte "Qepe! Qepe, ose përndryshe do të theri!". F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] në gjunjë dhe ai nuk e lejonte që të ngritet në këmbë. Ai vazhdoi që ta tërhoqte përtokë dhe e ka zvaritur në drejtim të një strehe afër shtëpisë së saj dhe thoshte "hajde qibemi". F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] munduar ta mbroj veten dhe ka tentuar që t'ia heq maskën kryerësit, mirëpo nuk ka arritur ta bëjë një gjë të tillë. Përfundimisht, F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] liruar dhe pastaj sulmuesi është larguar me vrapi. Ai akoma mbante maskën dhe mori thikën me vete. E tërë kohëzgjatja e incidentit, nga fillimi deri në fund, ka qenë rrëth 10 deri në 15 minuta.

Në bazë të rezultateve të hetimeve, Prokurori Publik në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP. Nr. 86/2009, të datës 24 qershori 2009, kundër të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] dhe e ka akuzuar për veprën penale Dhunim në tentativë në kundërshtim të nenit 193 paragrafit 2 pikave 1 dhe 2 në lidhje me nenin 20 të KPK-së.

Me aktvendimin e datës 22 shkurt 2010, Gjyqtari për konfirmim ka shpallur deklaratat e F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] siç janë dhënë në Polici më 21 dhe 22 prill 2009, si të papranueshme për shkak të faktit se ajo nuk është njoftuar lidhur me të drejtat e saj që të mos flasë. Me aktvendimin e datës 23 prill 2009, Gjyqtari për konfirmim ka hedhur poshtë aktakuzën (PP. Nr. 86/09) të datës 24 qershori 2009, për shkak të faktit se kryesisht ka qenë e bazuar në deklaratat e F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të cilat më parë janë shpallur të papranueshme.

Më 08 mars 2010, F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit të Gjyqtarit për konfirmim të datës 23 shkurt 2010.

Aktakuza është konsoliduar me vendimin mbi konfirmim nga gjykata e shkallës së parë (KA Nr. 46/09) të datës 13 korrik 2010. Të gjitha provat e marra gjatë hetimeve, përvèç procesverbalit të martjes në pyetje të viktimit F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] datës 21 dhe 22 prill 2009, të shpallur të papranueshme me anë të aktvendimit të datës 22 shkurt 2010, janë shpallur të papranueshme.

Më 26 korrik 2010, i pandehuri N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit mbi konfirmim të datës 13 korrik 2010.

Me aktvendimin e datës 03 nëntor 2010, një kolegi prej tre gjyqtarëve i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë ka refuzuar ankesën e të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] si të pabazuar dhe ka vërtetuar aktvendimin mbi konfirmim të datës 13 korrik 2010.

Shqyrtimi gjyqësor ka filluar përmes katër seancave më 14, 15 dhe 16 dhjetor 2010 dhe më 31 janar 2011, kur edhe është shpallur aktgjykimi i kundërshtuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka ekzaminuar të akuzuarin N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] dhe ka marrë në pyetje dëshmitaren H. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] (të dy më 16 dhjetor 2010). Për më tepër, shumë dokumente janë lexuar në procesverbal si: Raporti fillestare mbi incidentin i datës 21 prill 2009; fleta vazhduese nr. 1 e Raportit fillestare mbi incidentin të datës 21 prill 2009; raporti i policit i datës 21 prill 2009, raporti i hetuesit i datës 21 prill 2009 (i përpiluar nga Polici i Kosovës [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE], raporti i hetuesit i datës 21 prill 2009 ((i përpiluar nga Polici i Kosovës [REDAKTUE] fotografitë (faqet 120 – 149 të shkresave të lëndës); Raporti i Njësisë se krimeve rjonale në Mitrovicë i datës 21 prill 2009 (faqet 151-152 e shkresave të lëndës); Raporti identifikues i mjekësisë ligjore i datës 21 prill 2009; deklaratat e të pandehurit të dhëna më 22 prill 2009 dhe më 11 qershor 2009; deklaratat e palës së dëmtuar të dhëna më 21 dhe 22 prill 2009; Përshkrimi mjekësor nga Qendra Emergjente në Vushtrri i datës 21 prill 2009 dhe Raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor të N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] i datës 8 korrik 2009.

Në bazë të gjetjeve të tyre, më 31 janar 2011 Gjykata e Qarkut ka shpallur aktgjykimin e kundërshtuar dhe ka shpallur të akuzuarin fajtor për veprën penale të lartpërmendur. Si rrjedhojë, Gjykata i ka shqiptuar të akuzuarit dënimin e specifikuar më lart.

Avokati mbrojtës i të akuzuarit ka paraqitur ankesë të datës 23 maj 2010, brengë afatit ligjor kundër aktgjykimit dhe ka pretenduar dhe propozuar siç është cekur më lartë.

ZPShK-ja, me përgjigjen e datës 31 tetor 2011 të regjistruar në shkrimoren e Gjykates Supreme të Kosovës të datës 4 nëntor 2011 ka kundërshtuar ankesën dhe ka propozuar siç është cekur më lartë.

Më 13 dhjetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancë sipas nenit 410 të KPKK-së.

Prokurori publik i është referuar mendimit me shkrim të datës 31 tetor 2011 dhe ka propozuar siç është përshkruar në mendim.

### **GJETJET E GJYKATËS**

Ankesa është e pranueshme dhe e bazuar mirë.

Në përgjithësi, duhet të theksohet që tërë shkresat e lëndës përbajnë një numër të madh të mospërputhjes posaçërisht kur kemi të bëjmë me datat e dokumenteve të caktuara. Kështu, për shembull është, urdhri për ekzaminim psikiatrik të pandehurit që është lëshuar nga gjyqtari vendor i procedurës paraprake të datës 19 janar 2009 (fq.170 dhe 171 të shkresave të lëndës) përderisa vepra penale e pretenduar është kryer vetëm më 21 prill 2009; brenda dokumenteve të caktuara është përmendur viti 2006 dhe gjithashtu procesverbal i shqyrtimit gjyqësor nga seanca e datës 16 dhjetor 2009 përban – përkundër datës së 16 dhjetorit 2009 në letër përcjellëse – gjithashtu edhe datat 14 dhe 15 dhjetor 2009. Megjithatë, në vijim Gjykata Supreme do ti adresoj dobësitë që më së tepërmë bien në sy vetëm të aktgjykimit të ankimuar.

## A. Shkelja esenciale e procedurës penale

Avokati mbrojtës në ankesën e tij ka theksuar shkeljen esenciale të procedurës penale pasi që aktgjykimit të ankumuar do të mund ti mungoj arsyetimi i duhur dhe se arsyetimi i paraqitur nuk do të përputhet me faktet substanciale të lëndës. Prandaj, Neni 403, paragrafi 1, pika 12 e KPPK-së mund të shkëlet. Për më tepër, gjithashtu Neni 403, paragrafi 1, pika 8 e KPPK-së e gjithashtu edhe Neni 403 paragrafi 2 i KPPK-së do të mund të ishte shqetësues pasi që deklaratat e palës së dëmtuar të dhëna në polici me datën 22 prill 2009 janë shpallur të papranueshme me aktvendimin KA.nr. 46/09 të Gjykatës së Qarkut të datës 22 shkurt 2009 dhe aktakuza PP. nr. 86/09, e datës 24 qershori 2009 është refuzuar me aktvendimin KA.nr. 46/09 të Gjykatës së Qarkut të datës 23 shkurt 2009, ndërsa me aktvendimin e vërtetuar të datës 13 korrik 2010 aktakuza është konfirmuar. Përfundimisht, deklaratat e të pandehurit të dhëna në polici dhe te Prokurori Publik do të jenë të papranueshme pasi që ato janë dhënë në kundërshtim të Neneve 155 dhe 156 të KPPK-së.

Sa i përket mospërputhshmërisë së arsyetimit të aktgjykimit të kundërshtuar me dispozitivin dhe me gjendjen e vërtetuar faktike, në këtë pjesë është vërtetuar me pak fjalë që arsyetimi i aktgjykimit të kundërshtuar mbështetet në të dyja, deklaratat e të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] dhe deklaratat e viktimit R. [REDAKTUE] mirëpo nuk e pasqyron në tërësi dallimin në mes tyre. Prandaj, dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar së pari pasqyron deklaratat e R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të kryera nga disa gjetje tjera të cilat quben prova vërtetuese. Gjykata Supreme do të shtjelloj mbi këtë aspekt të aktgjykimit të kundërshtuar në mënyrë më të hollësisht me nën pikën C mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Supreme pajtohet që Neni 403, paragrafi 1, pika 12 e KPPK-së është shkelur në lëndën në fjalë.

Sa i përket papranueshmërisë së pretenduar të deklaratave të viktimit R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] Gjykata Supreme megjithatë gjen se me të vërtetë gjykata e shkallës së parë i ka bërë referencë këtyre deklaratave që iu ofruan policisë me 21 dhe 22 prill 2009 (fq.4 deri fq. 6 të aktgjykimit të kundërshtuar në versionit në gjuhën angleze), edhe pse me aktvendimin KA.nr. 46/09 të Gjykatës së Qarkut të datës 22 shkurt 2009 të dyja janë shpallur të papranueshme për shkak të faktit që R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] nuk është paralajmëruar nga policia lidhur me të drejtat e saj për të heshtur to. Ky vendim është konfirmuar me aktvendimin vërtetues të datës 13 korrik 2010, dhe i fundit përsëri është kundërshtuar me ankesën e të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të datës 24 korrik 2010 por megjithatë është vërtetuar me vendimin e kolegit prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 3 nëntor 2010. Është përtej të gjitha dyshimeve që aktvendimi mbi pranueshmërinë e deklaratave të R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] është bërë i formës së prerë, dhe për këtë arsy e gjykata e shkallës së parë nuk e lejuar që ti referohet atyre edhe më tej si prova.

Vlen të përmendet në këtë kontekst që është e mundshme që gjyqtari për konfirmim ka bërë gabim kur ai ka vendosur që deklaratat në fjalë të viktimit R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] si të papranueshme. Në bazë të Nenit 160, paragrafit 1, pikës 2 të KPPK-së pasi që është relevante në lëndën në fjalë, personi është i linuar nga detyra e dëshmimit kur ai/ajo "i/e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin, personat e gjinisë së gjakut në vijë anësore deri në shkallë të tretë [...]" .

Megjithatë, në lëndën në fjalë i pandehuri është djali i [REDAKTUE] dhe ky i fundit është vëllai i babai të viktimit. Që të dytë gjoja se i kanë babanë/prindërit e tyre të përbashkët. Prandaj, nga perspektiva e të pandehurit, viktima R. [REDAKTUE] është e gjinisë së gjakut me të nëpërmes babait, gjyshit dhe xhaxhait, d.m.th.: deri në shkallën e katërt. Si përfundim, R. [REDAKTUE] nuk ka pasur të drejtë për të heshtur para policisë, arsyesa e cila ajo nuk ishte paralajmëruar në mënyrë jo të duhur lidhur me të drejtat e saja.

Megjithatë, gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur të drejtë që vetëm të mos e përfill aktvendimin vërtetues. Në pajtim me Nenin 154, paragrafin 6, të KPPK-së "prova, e cila me aktvendim është konstatuar si e papranueshme, në një fazë të mëvonshme të procedurës me aktvendim mund të konstatohet si e pranueshme".

Gjykata e shkallës së parë nuk e ka lëshuar aktvendim të këtillë në lëndën në fjalë por vetëm ka përdorur si prova deklaratat e F. [REDAKTUE] të datës 21 dhe 22 prill 2009, edhe pse gjyqtari për konfirmim i ka shpallur ato të papranueshme. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se janë shkelur Neni 403, parografi 1, pika 8 e gjithashtu parografi 2 i KPPK-së.

Sa i përket shkeljes së pretenduar të Neneve 155 dhe 156 të KPPK-së lidhur me marrjen në pyetje të pandehurit për momentin duhet të lihet i hapur nëse i pandehuri është rrahu apo jo nga policia gjatë intervistimit të parë të pa-dokumentuar prandaj (si pasojë) vetëm të pretenduar të datës 21 prill 2009.

#### B. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Avokati mbrojtës në ankesën e tij ka theksuar vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pohuar kështu që provat e paraqitura kundër të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] nuk janë të mjaftueshme për të dëshmuar që i pandehuri ka qenë në vendin e ngjarjes natën e diskutueshme prandaj për atë arsy nuk është dëshmuar që ai ka kryer ndonjë veprim joligjor kundër viktimit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE]

Gjykata Supreme e Kosovës në të vërtetë nuk pajtohet me vërtetimin e gjendjes faktike dhe të vlerësimit të provave siç është kryer nga gjykata e shkallës së parë në lëndën në fjalë. Edhe pse kolegji nuk ka dyshime që viktima R. [REDAKTUE] është sulmuar në natën e 21 prillit 2009 nga njeriu i maskuar nga prapa dhe që autori i krimtit e ka detyruar atë brenda hangarit në fjalë bille duke e lënduar atë me thikë, duhet të provohet që gjykata e shkallës së parë nuk i ka konstatuar të mjaftueshme dhe nuk i ka vlerësuar provat lidhur me identitetin e të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] duke qenë autori përkatës i sulmit. Në vend të kësaj, gjykata e ka bazuar aktgjykimin mbi pretendime dhe tregues edhe pse shumë lehtë do të mund të ofroheshin prova të qarta.

Aktgjykimi i kundërshtuar i gjykatës së shkallës së parë, pas radhitjes së deklaratave të viktimit, R. [REDAKTUE] he të pandehurit, N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ka vërtetuar gjendjen themelore të lëndës siç është nxjerr në pah përparrë në fillim të aktgjykimit (Historiku i procedurës, fq. 3 të këtij aktgjykimi në versionin e gjuhës angleze). Aktgjykimi pastaj nxjerr në pah që "këto fakte janë të mbështetura nga deklaratat e qëndrueshme të F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] kur është dëgjuar nga policia më datën 22.4.2009 dhe në shqyrtimin gjyqësor e gjithashtu edhe shpjegimit që ajo e ka dhënë në Qendrën Emergjente kah ora

21.30 – pak kohë pas aksidentit. Deklaratat e saja vërtetohen më tutje me fotografitë në shkresa të lëndës duke treguar pantallonat e përbaltura të F. [REDAKTUE] Këto fakte gjithashtu janë në pajtim me deklaratën e N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të dhënë në stacion policorë me 22.4.2009 në të cilin ai theksoi që me datën 21.04.2009 rreth orës 20.00 ai shkoi në stacionin e autobusëve për të pritur F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE]. Ai kishte të veshur pallto të zezë dhe fanellë të zezë me mëngë të shkurtra të cilën ai e përdori për të mbuluar fytyrën e tij pasi që ai nuk ka dashur që dikush prej familjes së tij apo të familjes së F. [REDAKTUE] që ta njoh atë. Ai ishte duke e pritur atë, sepse sikurse ai tha, ata u pajtuan të takohen atë ditë që të kenë orgji seksuale. Kur ajo zbriti nga autobusi, tashmë ishte errësirë. Ai iu afroa asaj nga prapa. Ajo e njohu atë por tha që ajo ishte vonë dhe se familja e saj mund të dyshojnë diçka. Ai e kapi atë për dore të saj dhe e tërroqi mbi tokë me qëllim që të shkoj pas disa bllaqeve ashtu që mos të shihen nga ndokush. Ai gjithashtu kishte thikë me vete dhe e mbante në dorën e tij me qëllim të frikësimit të saj. Në bazë të deklaratës së tij, F. [REDAKTUE] gjithashtu tentoi ta tërheq atë më tutje por ata u ndalën tek bllaqet ku ata patën orgji seksuale për një kohë dhe pastaj u ndanë. N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] poħoi që F. [REDAKTUE] e kapi thikën derisa ata ishin së bashku dhe ai e morri prej saj por ai nuk e di se si ajo e preu dorën e saj. [...]”

Sa i përket identitetit të sulmuesit, aktgjykimi i shkallës së parë pastaj vazhdon duke theksuar që “edhe pse autor i krimtit ishte têrësisht i mbuluar me maskë në fytyrën e tij dhe i veshur me të zeza, F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] identifikoi N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] si autor të krimtit që nga fillimi i hetimeve” dhe që “ajo është në gjendje të njoh autorin e krimtit për shkak të gjatësisë dhe zërit të tij”. Për më tepër, deklaratat e saj janë vërtetuar me faktin që “fanella e zezë me mëngë të shkurtra që ishte përdorur nga sulmuesi për të mbuluar kokën e tij janë gjetur nga policia brenda shtëpisë së N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] gjithashtu edhe fanella me mëngë të shkurtra me njolla gjaku me siguri nga gjaku i F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ishte zbuluar në të njëjtën shtëpi. N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] dështoi të ofroj shpjegim të besueshëm të qenit (ekzistimit) të tij atje” (fq.9-10 të aktgjykimit të kundërshtuar në versionit në gjuhën angleze).

Gjykata Supreme në radhë të parë konstaton se që këto gjetje faktike nuk pasqyrojnë në têrësi se çka i pandehuri dhe viktima kanë theksuar para policisë, prokurorit publik dhe gjykatës.

#### Lidhur me deklaratat e ndryshme të pandehurit N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] shkresat e lëndës thonë si në vijim:

Sa i përket marrjes së pretenduar në pyetje të pandehurit nga policia tashmë me datën 21 prill 2009, i pandehuri ka pohuar se ishte rrahuar nga policia dhe se kjo situatë ka pasur ndikim në deklaratën e tij të dhënë më 22 prill 2009 para polisë, shkresat e lëndës nuk përmban asnjë informacion. Prandaj, Gjykata Supreme nuk mund të marr qëndrim lidhur me këto pretendime të ngritura nga i pandehuri.

Megjithatë, sipas Procesverbalit të marrjes në pyetje të dyshuarit me datën 22 prill 2009, i pandehuri theksoi para polisë që “me 21.04.2009 rreth orës 20.00 unë shkova prej shtëpisë time [...] në fshatin Stanovc i Ulët [...] dhe qëllimi im ishte të pres autobusin me të cilin shumicën e rasteve udhëton F. [REDAKTUE] [...] Unë isha i veshur me veshje (mbathura) sportive me ngjyrë hiri dhe bluzë me ngjyrë kuq e zi, pallto të zezë, një fanellë të zezë me mëngë të shkurtra me të cilën e kam mbuluar fytyrën, me qëllim që mos të njihem nga dikush prej familjes së [...] e gjithashtu edhe nga

familja ime. Unë po prisja [...] derisa të vinte F. [REDACTED] sepse unë u morra vesh me të njëjtën të mërkurën e fundit që të enjten që unë do të shkaj dhe të pres atë derisa ajo të arrij nga Prishtina me qëllim që të kemi akt seksual [...]. Unë nuk e ka vendosur [fanellën me mëngë të shkurtra] në fytyrën time derisa unë e pashë autobusin. [...] Kur F. [REDACTED] u afrova unë i thash asaj mos bërtit, jam unë, F. [REDACTED] më pyeti mua: a je ti N. [REDACTED] unë i thash po, të fillojmë me orgjinë seksuale, F. [REDACTED] më tha unë jam vonë, familja ime mund të supozoj gjithçka, Unë e kapa atë për dore, dorën e majtë e vendosa në shpinën e saj dhe për afro 5 minuta ne patëm orgji seksuale, ajo më shtyu mua dhe unë preva dorën me thikë, thika ishte e imja, unë e kisha në dorën time me qëllim të frikësimit të F. [REDACTED] kur ne patëm orgjinë seksuale, mua mu ngrit penisi, unë nuk guxoja të kisha akt seksual me F. [REDACTED] pasi që isha i frikësuar se do ta lë shtatzënë [...]. Kur ne patëm orgjinë seksuale, unë e kisha thikën në dorën time të djathië, kur ishim te blloqet gjatë orgjisë seksuale unë e vendosa thikën mbi tokë. F. [REDACTED] e kapi thikën dhe më thirri, unë isha i frikësuar se do të më qëllonte, unë e morra thikën por kjo ndodhi me dashje, unë nuk e di si F. [REDACTED] preu dorën dhe nuk e di se ndodhi e prera në dorën time, kur shkova në shtëpi unë vërejta gjakun në dorë, askush nuk më pa, unë e lava dorën me ujë [...]" .

Sipas Procesverbalit të marrjes në pyetje të pandehurit të datës 11 qershor 2009, i pandehuri në prani të avokatit të tij mbrojtës ka theksuar para prokurorit publik "Unë e di që isha në shtëpi duke lyer me gëlqere, nuk e di në qfarë kohe unë u largova që të shkoj në Vushtrri për të ecur dhe ky rast ndodhi, nuk e di se si ndodhi. [...] Lidhur me lëndën përkatëse, nuk më kujtohet që e kam parë F. [REDACTED] unë e tërroqat atë, e nxora thikën dhe ia drejtova asaj, asnjë fjalë nuk ia kam drejtuar, gjithashtu me thikë unë e kam prerë dorën e saj. Unë kam deklaratë në polici dhe unë e mbështhes atë".

Sipas Procesverbalit të Shqyrtimit Gjyqësor të datës 16 dhjetor 2010 i pandehuri ka theksuar që "Unë isha në shtëpi në shtëpinë e xhaxhait tim, duke gëlqerosur apo duke lyer muret. Ishte rrëth orës 6 pas dite. Isha në shtëpi duke lyer muret me babanë tim, nënën dhe të gjithë të tjerët. Gjersa isha duke i lyer muret dhe duke i pastruar dyert, erdhë policia" (procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 16 dhjetor 2010, faqe.25). Pas mohimit se ka përdorur ndonjëherë thikën kundër viktimit F. [REDACTED] apo se ai kishte gërvishtur fytyrën e saj, një fotografi e një këmishe iu tregua të pandehurit dhe ai e njobu atë fanellë që i përkiste familjes së tij. Ai e kishte veshur atë gjatë ngjyrosjes dhe i ndërrroi rrobat kur policia arriti dhe kërkoi nga ai të shkonte me ta (procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 16 dhjetor 2010, faqe 29). Në pyetjen e Gjyqtares Charpentier se a do të mund ta identifikonte fanellën e bardhë, i pandehuri u përgjigj: "Po. Është veshje". Në pyetjen tjetër të Gjyqtares Charpentier: "A mund të na shpjegoni pse në të ka disa njolla gjaku?" i pandehuri sqaroi: "sepse gjatë pastrimit të dyerve e preva gishtin tim. Është një sfunjjer me tel dhe gjatë pastrimit të njollave të gëlqeres unë e preva dorën time" (procesverbal i shqyrtimit gjyqësor i datës 16 dhjetor 2010, faqe 36).

#### Lidhur me dëshmitë e viktimit F. [REDACTED] Duke shkresat e lëndës shënojnë sic vijon:

Bazuar në Procesverbalin e Marrjes në Pyetje të Viktimës, F. [REDACTED] D. [REDACTED] ka dëshmuar më 21 prill 2009 para policisë se "Unë dyshoj në djalin e axhës tim, N. [REDACTED] D. [REDACTED] duke u bazuar në zërin dhe gjatësinë e tij".

Pas një dite, sipas Procesverbalit të Marrjes në pyetje të viktimitës të datës 22 prill 2009, P. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] ka dëshmuar se "Një person i panjohur për mua në fillim më ka sulmuar nga prapa. Pasi ky person u afria te unë, unë vërejta se ai ishte i veshur me të zeza; kishte një kapelë të zezë në kokë, kurse në fytyrë e kishte një fanellë të zezë. [...] ky person nxori nga trupi i tij një thikë mesatare dhe më kërcënoi: "Mbylle gojën se të ther, të vras", kur e dëgjova zërin, e kuptova se ky person ishte N. [...] N. [...] më liroi dhe vrapoi drejt rrugës kryesore e cila qon deri te shtëpia e tij. Pasi ai u largua, unë arrita në përfundim se ai ishte N. [...] unë e vërejta këtë në bazë të gjatësisë së trupit të tij si dhe kur ai filloj të vrapojë dhe të ikë nga vendngjarja. [...] Fillimisht unë nuk e dija se është N. [...] por kur ai filloj të më kërcënojë me thikë, unë e njoha zërin e tij dhe më pas e kuptova këtë kur ai u largua nga vendngjarja" (shkresat e lëndës, faqe. 176 deri 178).

Gjatë marrjes në pyetje të saj në shqyrtimin gjyqësor të datës 16 dhjetor 2010 P. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] dëshmoi lidhur me identitetin e të pandehurit se ishte kryerësi i Dhunimit në tentativë të pretenduar: "Unë e njoha se ishte ai (faqe. 4). Në momentin kur mu afria. Unë e pashë atë. Gjatësia e tij dhe gjithçka (faqe. 5)". Në pyetjen e Avokatit mbrojtës: "Si arritët në përfundim se ky person ishte N. [...] D. [...] kur ju thoni se ai ishte i maskuar?" dëshmitarja u përgjigj: "Siç thashë më herët ai edhe më parë tentoi t'i bënte gjërat e njëjta me mua. [...] Unë e njoha duke u bazuar në gjatësinë e tij. [...] Unë e di sa ai është i gjatë por nuk e di në metra e centimetra (faqe. 11)". Në pyetjen e Kryetarit të trupit gjykues: "A kishte diçka tjetër që të ndihmoi ta njihet atë?" ajo u përgjigj: "Unë e njeha atë". [...] Kryetari i trupit gjykues: "Pra a e njohet zërin e tij?" P. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] "Po". Kryetari i trupit gjykues: "Dhe zëri i kujt ishte?" P. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] "Tij" (faqe. 16-17).

#### Gjetjet e policisë:

Në fund duhet ti kushtohet vëmendje Raportit Mjeko-Ligjor të Identifikimit të datës 21 prill 2009 dhe të përpiluar nga Polici i Mjekësisë Ligjore [REDAKTUE] (KP #0192), i cili pohon se "[p]as ekzaminimit të venit të ngjarjes, nuk kemi mundur të gjejmë asnje gjurmë të dyshimitë, ne vazhduan te shtëpia e viktimitës [ku] afér derës së hyrjes së shtëpisë, përkatesisht në shkallën e katërt në anën e majtë kemi hasur në ngjyrë të kuqe, që dyshohet të jetë gjaku i viktimitës. [...] Pas kompletimit të kësaj prove, ne shkuam në shtëpinë e të dyshuarit [...]. Aty janë gjetur këto prova:

- *Prova 2 (Fanellë e bardhë në të cilën ishin disa njolla të kuqe, dyshohet të jenë gjak) është gjetur në anën e majtë të korridorit të shtëpisë së të dyshuarit [...]*
- *Prova 3 (Thika e dyshuar të jetë përdorur në këtë rast), është gjetur në anën e djathë po ashtu në korridor [...]*
- *Prova 4 (Bluzë e zezë) është gjetur në banjë [...]” (shkresat e lëndës, faqe. 153-154).*

Gjykata Supreme gjen se Aktgjyrimi i kundërshtuar nuk e ka vlerësuar mjaftueshëm gjendjen e provave.

Megjithëse Gjykata e shkallës së parë iu ka referuar dëshmive të P. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të datës 21 dhe 22 prill 2009 edhe pse të dyja ishin vendosur si prova të papranueshme siç u tha më herët, duket se Gjykata e shkallës së parë ka mbështetur mendimin e vet në fajësinë

e tē pandehurit N. [REDACTED] D. [REDACTED] kryesisht mbi dëshminë e tē pandehurit tē dhënë para policisë më 22 prill 2009. Në këtë kontekst i pandehuri vërtetë ka dhënë një tregim në bazë të cilil ai më datë 21 prill 2009 doli dhe u takua me viktimin P. [REDACTED] "orgji seksuale" pér çka më parë ishin pajtuar tē dytë. Megjithatë, pavarësisht se kjo dëshmi është larg tē qenit një pranim sa i përket veprës penale tē Dhunimit tē tentativë, Gjykata e shkallës së parë nuk e ka analizuar drejt këtë dëshmi në prapavijën e dëshmive tē mëvonshme tē tē pandehurit para Prokurorit Publik më 11 qershor 2009 dhe gjatës shqyrtimit gjyqësor më 16 dhjetor 2010, ku ai kishte revokuar dëshminë e tij tē mëparshme.

Madje edhe nëse e lejmë anash çështjen e papranueshmërisë së dëshmive tē P. [REDACTED] D. [REDACTED] këtë pikë (që Gjykata e shkallës së parë më vonë e ka bërë), Gjykata Supreme i merr parasysh dallimet serioze në dëshmitë e tē pandehurit N. [REDACTED] D. [REDACTED] i cili para policisë më 22 prill 2009 ka dëshmuar se ishte "*i veshur me rroba sportive ngjyrë hiri dhe bluzë ngjyrë kuq e zi, xhaketë tē zezë, një fanellë tē zezë me tē cilën e mbulova fytyrën time*" dhe tē dëshmitares dhe viktimit P. [REDACTED] D. [REDACTED] e cila gjatë marrjes në pyetje në polici në tē njëjtën ditë kishte theksuar se "*Unë e vërejta se ai ishte veshur në tē zeza; kishte kapelë tē zezë në kokë, kurse në fytyrë kishte një fanellë tē zezë*".

Këto dëshmi – në dallim me gjetjet e Aktgjykimit tē kundërshtuar – nuk vërtetohen me provat e gjetura në shtëpinë e tē pandehurit, që në veçanti (përveç thikës) ishin një "bluzë e zezë" dhe një "fanellë e zezë në tē cilën ishin disa njolla tē kuqe që dyshohet tē jenë gjak". Pavarësisht se sendi i shënuar si prova D4 dhe e treguar në fotografitë #22 dhe #23 tē shkresave tē lëndës vërtetë shfaqin një bluzë tē zezë, është me rëndësi se as i pandehuri e as viktima asnjëherë nuk e kanë përmendur se sulmuesi i P. [REDACTED] D. [REDACTED] kishte tē veshur bluzë tē zezë.

Po ashtu gjetja e Gjykatës së shkallës së parë se "*fanella e zezë që ishte përdorur nga sulmuesi pér mbulimin e fytyrës së tij ishte gjetur nga policia brenda shtëpisë së N. [REDACTED] D. [REDACTED]*" nuk ka asnjë bazë në shkresat e lëndës. Asnjëherë nuk është vërtetuar se fanella e zezë nga shtëpia e tē pandehurit (dhe në botë ka shumë fanella tē tillë), tē cilën i pandehuri gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor tē datës 16 dhjetor 2010 (faqe.29 e versioni në Gjuhën Angleze) e ka identifikuar se i përket familjes së tij ishte identike me fanellën tē cilën sulmuesi i P. [REDACTED] D. [REDACTED] kishte përreth kokës së tij.

E fundit por jo më pak e rëndësishme, Gjykata Supreme është e pakënaqur tē vërtetojë se sa i përket fanellës së zezë nga shtëpia e tē pandehurit, që më herët asnjëherë nuk është përmendur gjatë rrjedhës së hetimeve, Gjykata e shkallës së parë ishte e kënaqur tē pohojë se "*është zbuluar edhe një fanellë e bardhë me njolla gjaku me gjasë nga gjaku i P. [REDACTED] D. [REDACTED] [...] fajqe.10 e Aktgjykimit tē kundërshtuar në versionin në Gjuhën Angleze*

. Edhe pse P. [REDACTED] D. [REDACTED] kurrë nuk ka përmendur një fanellë tē bardhë tē sulmuesit tē saj dhe i pandehuri N. [REDACTED] D. [REDACTED] gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 16 dhjetor 2010 ka dhënë një sqarim pér njollat e gjakut, që do tē ishte gjaku i tij, i rrjedhur nga plaga që ai e mori gjersa ishte duke zbardhuar muret e shtëpisë së axhës së tij, Gjykata e shkallës së parë në vend tē kërkojë një ekspertizë mjekoligjore ka kufizuar veten në dëshminë se "*N. [REDACTED] D. [REDACTED] nuk ka arritur ta japë një sqarim bindës pér ekzistencën e kësaj aty*".

Vetëm duhet tē përmendet përveç kësaj se sa i përket asaj që F. [REDACTED] D. [REDACTED] thënë se ajo mund ta njohë tē pandehurin pér shkak tē gjatësisë së tij, mënyrës se lëvizjes së tij

dhe zërit të tij, nga ajo asnjëherë nuk është kërkuar të japë më shumë hollësira përkitazi me veçoritë eventuale në mënyrën e lëvizjes së tij, e cila do të ishte tipike për të pandehurin, as nuk është bërë krahasimi i zërit, duke kërkuar nga viktima R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të bëjë pa asnjë kontakt me sy identifikimin e zërit të të pandehurit në mes të një numri të zërave (meshkujsh), të gjithë ata duke i shqiptuar kërcënimet e bëra R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] nga kryerësi.

### C. Shkelja e Ligjit Penal

Avokati mbrojtës ka theksuar në ankesën e tij se veprimet e të pandehurit ishin cilësuar juridikisht gabimisht si Dhunim në tentativë në përputhje me Nenin 193 paragrafin 3 pikën 3 lidhur me Nenin 20 të KPK-së, mirëpo duke u bazuar madje edhe në dëshmitë të viktimit R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] do të jepej vetëm vepra penale e Lëndimit të lehtë trupor në përputhje me Nenin 153 paragrafin 4 të KPK-së. Përveç kësaj, përgjegjësia penale e të pandehurit nuk ishte analizuar nga Gjykata e shkallës së parë.

Për shkak të gjetjeve të nënvisuara më herët, Gjykata Supreme tani për tani përbahet nga vlerësimi i çështjes së cilësimi të gabuar juridik të pretenduar të veprimeve kundrejt viktimit R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] Mund të vërtetohet vetëm se cilësimi i Dhunimit në tentativë varet nga analiza e kujdeshshme e kritereve subjektive të Ligjit pasi që ekziston vullneti dhe dëshira e kryerësit. Një analizë e tillë mungon në lëndën në fjalë. Kjo e fundit shumë lehtë ka mundur të bëhet duke bërë krahasimin e dëshmisi së N. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] të datës 22 prill 2009 dhe pretendimin e tij se kishte marrëveshje me R. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] për të pasur "orgji seksuale" dhe pretendimet e F. [REDAKTUE] D. [REDAKTUE] në dëshmitë e sajë të ndryshme se kryerësi donte ta dhunonte.

Megjithatë, Gjykata Supreme gjen se Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë asnjë përpjekje përkitazi me gjendjen e besueshmërisë penale së të pandehurit, edhe pse çështja e afeksionit të pretenduar psikologjik të të pandehurit ishte e njohur për Gjykatën dhe e diskutuar bazuar në faktin se i pandehuri kinse ka shfaqur disa sjellje që bien në sy dhe ka deklaruar para Prokurorit më 11 qershor 2009 se si rregull ai nuk mund të mban mend dëshmitë e tija të mëparshme edhe në rastet kur këto dëshmi janë dhënë para pak kohësh.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se ankesa është e pabazuar edhe në këtë aspekt. Pavarësisht se çështja e veçantë e besueshmërisë penale së të pandehurit N. [REDAKTUE] I. [REDAKTUE] ishte ngritur nga Mbrojtja në mes tjerash në ankesën e tij, por me sa duket nuk ishte analizuar ose marrë në konsideratë fare më herët, çështja bie nën fushën e shqyrtimit ankimore dhe prandaj duhet të ekzaminohet nga Gjykata madje *ex officio*, në përputhje me Nenin 404 pikën 2 të KPPK-së.

Neni 12 i KPK-së referohet, i cili përcakton:

(I) Personi i cili ka kryer vepër penale konsiderohet i paafshi mendërisht nëse në kohën e

kryerjes së veprës penale lëngonte nga një sëmundje mendore e përkohshme ose e përhershme, nëse kishte çrrëgullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor, që e ka prekur funksionimin e tij mendor, dhe, si pasojë e kësaj, nuk ka qenë në gjendje t'i kuptojë ose t'i kontrollojë veprimet a mosveprimet e tij apo t'u kuptojë se kryen vepër penale.

(2) Person i cili ka kryer veprer penale konsiderohet se ka afiesi te zvogeluuar mendore nese ne kohen e kryerjes se veprer penale afiesia e tij per te kuptuar apo per t'i kontrolluar veprimet a mosveprimet e tij ka qen dukshem e zvogeluuar per shkaqet e cekura ne paragrafin 1 te ketij nen. Personi i till e konsiderohet penalish pergjegjes, por keto rrethana merren parasysh nga gjykata kur vendos per kohezgjaljen dhe llojin e sanksionit ose masen e trajtimit te detyrueshem.

Lidhur me ket te duhet te nenvizohet se Prokurori Publik ka paraqitur njeh propozim per ekspertize psikiatrike ne kohen kur lenda ishte ende ne prite te Prokurori Publik. Ceshja e ekspertizeve po ashtu esht diskutuar edhe gjat shqyrtimit gjyqesor. Kjo e fundit mund te kuptohet nga procesverbali i shqyrtimit gjyqesor i dates 16 dhjetor 2009, (faqe.21 e versionit ne Gjuhen Angleze). Edhe pse per te te gjitha dyshimeve ne përputhje me gjetinat ekspertiza u urdherna nga Gjyqtari i procedurës paraprake sipas dokumentit ne faqe. 170/171 te shkresave te lendes (i cili jep daten 19 janar 2009), Prokurori Publik nuk arriti ta siguroje ekspertizën gjate seancës se shqyrtimit gjyqesor me 16 dhjetor 2010. Megjithat, nga procesverbali perkatës mund te kuptohet se Gjykata e shkallës se pare ishte ne posedim te ekspertizeve se datës 08 korrik 2009, ku kjo e fundi ishte diskutuar gjate seancës se shqyrtimit gjyqesor me 16 dhjetor 2010 siç vijon:

"Kryetari i kolegit: Ndërsa kjo ekspertiza nga Qendra Klinike Universitare e Prishtinës, nga reparti i psikiatrisë? Kjo ekspertize nuk ka fare numra ne faqet e saj, [...].

Prokurori publik: Esht leshuar nga gjykata me propozim te prokurorisë, por kam frike se nuk e kemi atë provë. [...]

[REDACTED] a dhe z. [REDACTED] e keni parë ket te ekspertize?

[REDACTED] Jo, kemi kerkuar njeh gjë te till por nuk na esht dhënë.

Kryetari i kolegit: Pasi qe palët nuk e kanë parë ekspertizën e datës 8 korrik 2009, ju sugeroj te marrim njeh pauzë prej 20 minutash ne menyrë qe te bëhen kopjimi i saj [...] dhe qe e njëjtë t'u dorëzohet palëve [...].

Ndërkohe, palëve iu esht dorëzuar raporti i ekspertizeve. Sugeroj qe te marrim njeh pauzë prej 15 minutash me qellim qe t'iu mundësojmë atyre ta lexojnë reportin. Pastaj do te komentojmë nese i njëjti rapport duhet te përfshihet ne prova materiale apo jo. [...] Z. Prokuror publik, pas jeni njoftuar me ekspertizën a keni dëshirë qe e njëjtë te përfshihet si provë materiale?

Prokurori publik: Po.

[REDACTED] Ne dëshirojmë qe e njëjtë te përfshihet si provë.

[REDACTED] Nuk kundërshtojmë provën ne fjalë. [...]

Kryetari i kolegit: Gjykata konstaton se te gjitha provat e propozuara nga Prokurori publik janë te pranueshme dhe prandaj pranohen si prova materiale. [...] Gjykata

*pranon si provë të gjitha materialet e përmendura nga Prokurori publik duke përfshirë këtu edhe ekspertizën e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, të datës 08. 07. 2009. Tash pyetja ime për palët është kjo: a dëshironi të lexohen të gjitha provat apo mund t'i konsiderojmë të njëjtat si të lexuara?*

*Prokurori publik: Mund t'i konsiderojmë si të lexuara.*

**[REDAKTUE] Ne mbështesim propozimin e bërë nga Prokurori publik.**

**[REDAKTUE] [...] Vetëm sa për t'u sqaruar – [...] Në shkresat e lëndës të cilat i kam pranuar më herët numrat e faqeve nuk përpulohen me numrat të cilët tash janë propozuar nga ana e Prokurorit publik.**

*Kryetari i kolegjit: Nëse është kështu puna atëherë do të kërkoj nga Prokurori publik që të na japë numrat e faqeve dhe të bëjë një përshkrim të shkurtër të provave.*

*Prokurori publik: [...] Në fund raporti i Qendrës Klinike Universitare të Kosovës nuk ka numra të faqeve në shkresat e Prokurorit publik. [...]*

*Kryetari i kolegjit: Me pajtimin e të gjitha palëve, të gjitha dokumentet konsiderohen si të lexuara" (procesverbal i shqyrtimit gjyqësor të datës 16 dhjetor 2010, faqe 20 deri në faqe 24).*

Ekspertiza mjekësore e datës 8 korrik 2009 pasi që është e rëndësishme në këtë kuptim, lexon si më poshtë:

*"Ekspertiza psikiatrike [...] është bërë duke u bazuar në urdhrin e [...] Gjykatës së Qarkut [...] me qëllim të konstatimit të faktit nëse [N...D...] ka qenë në gjendje të çrregulluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse i njëjti vuan nga ndonjë çrregullim mendor. [...]*

*Pacienti ka një shkallë të ulët të kapacitetit mendor, me nivel të topitjes, me koeficient të inteligjencës IQ ca. 75. Nuk ka prani të pasqyrës psikopatologjike në përbërjen mentale [...] dhe nuk ka [...] elemente të cilat tregojnë për ndonjë paqëndrueshmëri emocionale [e cila nënkuption "ndryshueshmëri"]. Profili emocional PIE e paraqet të njëjtin si një individ i cili dominohet me orientim kah epshi pa ndonjë ndjeshmëri të thellë emocionale. [...] Rezultatet e vlerësimit psikologjik nuk tregojnë për ndonjë funksion të çrregulluar psikologjik të njohjes, d.m.th. nuk ka elemente të veçimit apo izolimit psikologjik. [...]*

*Lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet, ai ka një kapacitet të ulët të të kuptuarit apo të kontrollit të veprimeve të veta por jo në masë të madhe".*

Gjykata Supreme së pari konstaton se informata e ofruar nga ekspertiza përkatëse mjekësore nuk është vërtet e plotë kur kemi të bëjmë me çështjen e përgjegjësisë së zvogëluar penale apo për mungesën e plotë të një përgjegjësie të tillë tek i pandehuri N...D... e cila gjë kërkon aftësi të zvogëluara të kryerësit në fjalë si për të kuptuar ashtu edhe për kontrolluar veprimet e veta në kohën e kryerjes së veprës penale. Ekspertiza iu referohet në mënyrë të qartë këtyre kushteve vetëm përmes një fjalie, e cila është e fundit në citimin e mësipërm. Ekspertiza, duke theksuar se i pandehuri "ka

*një kapacitet të ulët të tē kuptuarit apo tē kontrollit të veprimeve të veta por jo nē masë të madhe*", nē mënyrë të qartë mundohet tē ndjekë kushtet e përcaktuara me Nenin 12, par. 12 tē KPK-së siç është cituar edhe më lart nē këtë Aktvendim, por nuk e lidh këtë rezultat me arsyetimin e kuptueshëm nē mënyrë logjike.

Përkundër kësaj, çështja e përgjegjësisë penale tē tē pandehurit duhet që tē merret parasysh *ex officio* nga ana e trupit gjykues prandaj duhet tē adresohet nē mënyrë të përshtatshme nē vendimin e gjykatës, sa herë që ka shenja pér ndonjë shqetësim tē mundshëm nē këtë drejtim. Në rastin nē fjalë, edhe pse raporti përkatës mjekësor gjithashtu radhitet si provë materiale me numrin 15 nē Aktgjykimin e kundërshtuar (faqja 4 e versionit nē gjuhën angleze), Gjykata e shkallës së parë nuk ka harxhuar madje asnjë fjalë tē vetme sa i përket domethënies së raportit apo gjendjes së përgjegjësisë penale tē tē pandehurit, pér tē cilën kjo e fundit ka mundur tē sugjeronte duke pasur parasysh raportin përkatës mjekësor tē përmendor më lart.

#### D. Vendimi mbi dënimin

Avokati mbrojtës nē fund ka theksuar se dënimini prej shtatë (7) vjetësh burgim do tē ishte tejet i ashpër pér shkak tē faktit se i pandehuri, nē bazë tē raportit mjekësor tē Klinikës së Psikiatrisë vuante nga ngecja nē zhvillimin mendor – intelektual prandaj si pasojë e kësaj ai kishte një aftësi tē ulët tē tē kuptuarit dhe tē kontrollit ndaj veprimeve tē veta.

Gjithashtu nē këtë drejtim, Gjykata Supreme përbahet nga vlerësimi i gjetjeve tē cilat kanë tē bëjnë me dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë, duke pasur parasysh gjetjet ashtu siç janë theksuar më herët. Përveç çështjes së rikualifikimit tē mundshëm tē veprës penale si Lëndim i lehtë trupor nē vend tē Dhunimit nē tentativë, siç është thënë edhe më herët, referimi ka tē bëjë me atë çfarë është thënë nën pikën C. tē këtij Aktvendimi.

Edhe nē qoftë se Gjykata do tē vinte tek përfundimi se i pandehuri ka pasur përgjegjësi penale nē kohën kur ka kryer veprën penale, ka nevojë tē diskutohet ndikimi eventual i "kapacitetit tē tij tē ulët mendor" siç është konstatuar me ekspertizën mjekësore, nē vendimin mbi dënimin nē bazë tē Nenit 12, paragrafit 2 tē KPPK-së.

Për arsyet e përmendura më lart, Gjykata Supreme ka vendosur si nē dispozitiv.

#### Anëtarët e kolegit:

---

Anne Kerber  
Gjyqtare e EULEX-it

---

Nesrin Lushta  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Emine Mustafa  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

---

Salih Toplica  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

**Kryetari i kolegjit:**

---

Gerrit-Marc Sprenger  
Gjyqtar i EULEX-it

**Procesmbajtësi**

---

Holger Engelmann  
Zyrtar ligjor i EULEX-it